

BIBLIOTEKA

398

E 71



**EPI I**

**GILGAMESHIT**

1. 2. 3. 4. 5. 6. 7. 8. 9. 10. 11. 12. 13. 14. 15. 16. 17. 18. 19. 20. 21. 22. 23. 24. 25. 26. 27. 28. 29. 30. 31. 32. 33. 34. 35. 36. 37. 38. 39. 40. 41. 42. 43. 44. 45. 46. 47. 48. 49. 50. 51. 52. 53. 54. 55. 56. 57. 58. 59. 60. 61. 62. 63. 64. 65. 66. 67. 68. 69. 70. 71. 72. 73. 74. 75. 76. 77. 78. 79. 80. 81. 82. 83. 84. 85. 86. 87. 88. 89. 90. 91. 92. 93. 94. 95. 96. 97. 98. 99. 100.

398

ETI

# EPI I GILGAMESHIT

E përktheu nga gjermanishtja dhe  
e plotësoi me shënime

**ANTON BERISHA**

SHKURTICIA & SHKURTICIT  
SHKURTICIA & SHKURTICIT  
45778

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Përkthimi u bë nga:  
GILGAMESCH  
*Eine Erzählung aus dem alten Orient*  
Zu einem Ganzen gestaltet von  
Georg E. Burckhardt  
Im Insel Verlag zu Leipzig

Redaktorë:

AUREL PLASARI  
JORGJI DOKSANI

Kopertina

ALMA XHAFA

Recensues

RAMAZAN VOZGA

## Dy fjalë për përkthuesin

Anton Berisha, shkrimtar e studiues i njohur, lindi në Dobërdol të Klinës, Kosovë, më 1946.

Shkollën e mesme dhe Fakultetin Filozofik, Dega e Letërsisë, i kreu në Prishtinë. Më pas kreu dhe studimet pasuniversitare në Zagreb, ku dhe mbrojti tezën e doktoraturës në letërsi. Është bashkëpunëtor i lartë shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Ka botuar mjaft libra me studime e ese, me letërsi për fëmijë etj., mes të cilëve përmendim veprimet «Përkime poetike» (1978), «Mundësi interpretimi» (1979), «Çështje të letërsisë gojore» (1982) etj.



## VEPËR KUSHTUAR TMERRIT TË VDEKJES

*Utnapishtimi i flet Gilgameshit:  
«Pushoje vajin, frenoje zemërimin!  
Fate të ndryshme kanë hyjt e njerëzit:  
Baba e nëna t'pollën si njeri.  
Ndonese dy t'tretat hyjnore i ke,  
të njerëzve e ke ti një të tretën  
që të tërheq kah fati i njeriut.  
Amshimi s'është dhënë për njeriun!  
Vdekja mizore është, cakton çdo fat».*

(Nga kënga e njëmbëdhjetë)

### 1. Esenca dhe aktualiteti i epit

Njëri ndër objektet artistike, të trajtuar shpesh në veprat letrare, është edhe raporti midis jetës dhe vdekjes — gjithë ajo që i afrohet dhe i largon këto dy fenomene me rëndësi për njeriun dhe botën e tij. Thua se nuk ka vepër letrare që, në një mënyrë ose në një tjetër, nuk ka shtruar e nuk ka shqiptuar elemente të jetës dhe të vdekjes. Dhe, meqenëse secili

krijues këto fenomene i ka parë e vështruar në mënyrë vetjake, përherë ka shprehur e ka theksuar diçka të veçantë, diçka tjetër nga ajo që është thënë më parë, dhe në këtë mënyrë është pasuruar përvoja e njeriut për jetën dhe vdekjen.

Në rrethin e ngushtë të veprave që si objekt kryesor artistik kanë raportin e jetës dhe të vdekjes është pa dyshim Epi i Gilgameshit,<sup>1</sup> vepra më e vjetër e shkruar dhe e zbuluar deri më sot, rreth 4000 vjet e lashtë. Kjo vepër e letërsisë së Mesopotamisë edhe sot e gjithë ditën imponohet si vepër me rëndësi esenciale, por dhe aktuale. Kur themi këtë kemi parasysh problemet qenësore që shtrohen në të dhe mënyrën e shqiptimit të tyre, transponimin e botës së njeriut në një periudhë të caktuar të zhvillimit të tij. Sidomos duhen veçuar qasja dhe shqiptimi poetik i përpjekjeve të njeriut për t'i shpëtuar vdekjes, përkatësisht për ta gjetur jetën e amshuar dhe forcën e rinisë. Pra, në esencën e sistemit kuptimor dhe shprehës, Epi i Gilgameshit i kushtohet tmerrit të vdekjes dhe fatit tragjik të njeriut. Tashmë është e ditur se vdekja përmyll fatin e çdo qenieje të gjallë, por njeriu këtë e përjeton në mënyrë të veçantë, sepse bëhet i vetëdijshëm se duhet të vdesë, sikur ngjet edhe me kryepersonazhin e kësaj vepre të lashtë, Gil-

1) Për letërsinë e Mesopotamisë, përkatësisht për traditën letrare sumero-babilonase, për traditën e shkrimit me kunja (shkrimin kuneiform), për vjetërsinë e Epit të Gilgameshit, kur dhe si u zbulua, për perënditë, për qeniet që përmenden në të, për vendbanimet etj., shih më gjerësisht në pjesën *Të dhëna e shënime*.



gameshin. Si mbret i Urukut, njeri i hareve dhe i gëzimeve, ai nuk kishte menduar sa duhet për kuptimësinë e jetës dhe vdekjen e njeriut. Vetëm vdekja e Enkidujit i jep të kuptojë, pra, e bind se edhe ai duhet të vdesë. Ky vetëdijesim ndikon që Gilgameshi ta ndërrojë qëndrimin ndaj jetës dhe të vihet në kërkimin e jetës së amshuar, ashtu sikur jetonin perënditë. Kjo ide e vetëdijesimit për vdekjen del qartas edhe në mallkimin e Enkidujit, drejtuar gruas së hyjnueshme, e cila e harlasi, e ndau nga kafshët dhe e ktheu te njerëzit: Nga se në mua ti kureshtjen zgjove/ që të mësoj... Pra, e bëri të jetë i vetëdijshëm për vetveten, për fatin e tij, për botën.

Në Epin e Gilgameshit shprehen e ballafaqohen tri botë: ajo hyjnore, njerëzore dhe shtazore, që dëshmojnë për një stad të lashtë të ekzistencës, që në ep paraqiten mjaft unike; ato janë në raport veprues dhe kushtëzues reciprok. Si i këtillë Epi i Gilgameshit imponohet si një vepër e pasur idesh, si një sistem i ngritur kuptimor e shprehës, që përkundër faktit që vjen nga një periudhë e lashtë, komunikon intensivisht me botën tonë, me problemet esenciale dhe me dilemat që e cilësojnë njeriun e sotëm në procesin e ekzistimit dhe të veprimit, pra për shumë veçori ajo është vepër aktuale dhe moderne në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.<sup>1</sup> Mirëpo vlera e saj qëndron edhe në faktin se

1) Mendimet dhe konstatimet për Epin e Gilgameshit në këtë punim kanë të bëjnë me tekstin e plotësuar nga G. Burkhardt, përkatësisht me tekstin e përkthyer në gjuhën shqipe që po i prezantohet lexuesit e jo me tekstet e tjera me zbrastës (Shih më gjerësisht: *Dy fjalë për përkthimin*).

shumë ide e mendime, forma të transponimit e të shqiptimit të botës së njeriut, të krijimit të tablove poetike e të përshkrimeve të natyrës etj., u shfrytëzuan dhe u bënë objekt trajtimi në shumë vepra letrare të mëvonshme.<sup>1</sup>

## 2. Botë-realitet specifik

Gjithë ajo që shqiptohet në *Epin e Gilgameshit* dëshmon, siç u theksua, për një botë sa të lashtë, po aq të pasur e specifike. Bota njerëzore shprehet nëpërmjet *Gilgameshit*, mbretit të Urukut, dhe njerëzve që jetojnë me të. Bota e perëndive është jashtëzakonisht e pasur dhe ka funksion të shumëfishtë në ep; nga hyjnitë përcaktohet fati i njerëzve dhe i kafshëve. Bota shtazore, po ashtu, është e pranishme në këtë vepër dhe ndërliidhet mjaft mirë me dy botët e tjera. Në të vërtetë, kufijtë midis këtyre tri botëve shkrihen. *Gilgameshi*, njeri dhe mbret i Urukut, i ka dy të tretat të hyjnive. *Enkiduji* në fillim të ekzistencës së tij (pasi e krijon hyjnesha *Aruru*) rri dhe kullot barin me kafshët e pyllit. Njeriu-akrep (*skorpion*) ka elemente të kafshës dhe të njeriut. Edhe *Humbaba*, rojë e malit hyjnor, *Cedrit*, paraqitet si

1) Për prezencën e Epit të *Gilgameshit* në letërsinë botërore shih, pos të tjerash, P. Jensen: *Das Gilgamesch-Epos in der Weltliteratur*, Strassburg, 1906; Hugo Gressmman: *Einleitung* në: *Das Gilgamesch-Epos*, Göttingen, 1911, f. 82-232, si domos *Die Nachwirkung des Epos in der Weltliteratur*, f. 182-190.